



Adresa: rr. "Adem Jashari", pn, vvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel. 028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 15. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 dhe nenit 11. par. 1. pika 2. të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04.mars/2004, nenit 38.pika1.2, 1.3. dhe 1.4. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në mbështetje të dispozitave të Vendimit të KK-ës Gjilan, nr. 01-3748/0101, dt. 16.04/2008 për miratimin e Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban : "Kampi Montith", Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 27.05.2013, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban: " Kampi Montith"

1.

Me këtë Vendim, miratohet Plani Rregullues Urban: "Kampi Montith", i Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejshëm: PRrU: "Kampi Montith", i cili përfshinë hapësirën në mes rrugës magjistrale: Gjilan- Bujanovc, duke filluar nga Ura mbi lumin Stanishor te hyrja në Kazermen e FSK-ës, duke vazhduar në drejtim të Bujanovcit deri te kufiri i Fabrikës së Baterive NiCD ku në këndin 90% kthehet në të djathtë, duke përcjellë kufirin deri te prroi përkatsisht rruga e arave, trasës së Autorrugës dhe Hekurudhës të parapara me PZHK/PZHU, ku kthehet në të djathtë përgjatë rrjedhës së proit nëpër livadhe deri te kthesa e madhe afër Qeshmes në Kuvçë të Ultë, ku kthehet në drejtim të Gjilanit duke përcjellë rrugën ekzistuese: Malishevë-Gjilan, dhe rrjedhën e lumit deri te ura përbri Kazermës së FSK-ës. në sipërfaqe rreth 110.00 ha (njëqinddhjethektar).

2.

PRrU: "Kampi Montith ", është hartuar nga kompania: " XL-Architeks" nga Prishtina.

3.

Dokumenti nga pika paraprake e këtij Vendimi, vërtetohet me Vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit në pesë ekzemplar të shkruar dhe 5 kopje digjitale dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

4.

Plani nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit, organizimin dhe destinimin e hapësirës së këtij lokacioni, përcakton rregullat dhe kriteret e ndërtimit te objekteve banimore-afariste dhe rrjetit të objekteve publike dhe objekteve të Infrastrukturës teknike komunale.

6.

PRrU: "Kampi Montith", duhet të inkorporohet në Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

7.

Parcelat e përfshira me këtë plan e të cilat janë të destinuara për objekte publike dhe objekte të infrastrukturës komunale, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me Interes të Përgjithshëm Publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

8.

Për zbatimin e këtij vendimi, do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorisë për Shërbime Publike të KK-ës Gjilan.

9.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës.

A r s y e t i m

i Propozim Vendimit për miratimin e Planit Rregullues: "Kampi Montith", në Gjiilan

Bazë juridike për miratimin e Vendimit të Planit Rregullues Urban: "Kaampi Montith", është Statuti i Komunës së Gjilanit, Vendimi i KK-ës Gjilan për miratimin e Planit Zhvillimor Urban, nr. 01.11735, dt. 30.10 2008, Vendimi i KK-ës Gjilan, për qasjen e hartimit Tw PRRU: "Kampi Montith" nr. , nr. 01-3748/0101, dt. 16.04/2008, Ligji për Planifikimin e Hapsinor, nr. 14/2003, Ligji për Ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106 dhe dispozitat që burojnë nga ato ligje.

PRRU: " Kampi Montith", pjesa më e madhe e ka qenë e përfshirë edhe me heret me Plane Detaje Urbansitike: (PDU: " Qenar Qeshme", e viteve 70-ta; dhe PDU: "Qenar Qeshme-1" i vitit 1984) dhe shtrihet në pjesën Jugore Qytetit të Gjilanit dhe me interefime të drejtëpërdrejta edhe në pjesët-zonat tjera të pjesëve tjera, në jug me fshatin Velekincë; në pjesën jug përfundimor dhe veriore (PRRU: "Kodra e Thatë" dhe PRRU: "Iliria", me pjesën lindore me PDU: Arberia 2" (ish Qenar Qeshme -2") si dhe rrugën Gjilan-Preshev, rr. e Vjetër: Gjilan - Kumanovë; si dhe Magjistralen e Planifikuar Prishtinë – Gjilan - Kumanovë dhe është një hapësirë kompakte.

Kjo hapësirë në një sipërfaqe rreth 100 hektar, me një konfiguracion të ndryshëm, është pjesërisht e ndërtuar, dominon banimi Individual, me një koncentrim të theksuar të objekteve banimore-afariste përgjatë tërës së rrugës Gjilan - Preshevë, e ngarkuar për komunikim dhe frekuentim e sidomos pa qasje adekuate në rrugën Magjistrale: Gjilan Ferizaj, pa rrugë të mirëfillta brendapërbrenda kompleksit, me pak objekte të karakterit të përgjithshëm public: pëveq që përkufizohet me Sh.F " A. Ajeti", me QMF dhe Parkun në Lagjen: "Arberia-2" dhe dy ndërtesa të Banimit Social si dhe kompleksin evarrezave të Qytetit, rrjete jo funksionale të Infrastrukturës teknike komunale, të cilat për shkak të manëgësive të ndryshme nga amortizimi, kapaciteti dhe mosrealizimi i tyre nga Planet paraprake, jo edhe aq funksionale.

Ky Plan përmban normativa teknike, standarde si dhe zgjidhje urbanistike dhe rregullative specifike të organizimit të shfrytëzimit të hapësirës dhe të ndërtimit të objekteve të banimit dhe afarizmit, objekte të arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, etj., përmbajtje dhe objekte të infrastruktures teknike komunale: rrugëve primare dhe sekondare, trotoareve, stazave dhe aleve të ndryshme, hapësirave të lira dhe gjelbërimit, rregullimit të rrjeteve të ujësjellësit, dhe rrjetit të kalalizimit atmosferik dhe fekal, i cili është trajtuar në mënyr specifike për shkak të dhe tri rrjedhave që duhet të realizohen veqmas për shkak të konfiguracionit të terrenit, me qëllim të krijimit të kushteve dhe mundësive për një jetë dhe veprim të mir organizuar dhe mundësisë për zhvillim bashkohor dhe të qëndrueshëm.

Gjat procesit të hartimit të këtij plani, ka pas një pjesmarrje solide të pronareve të tokave-objekteve të përfshira me këtë plan, ndërsa shqyrtimi public është mbajtur nga data: **07. Nëntor/2012, deri më datë: 07. Dhjetor/2012**, duke dhënë vërejtje, sugjerime dhe propozime konkrete për organizimin e shfrytëzimit racional të hapësirave konkrete, për profilin e rrugëve dhe rrjeteve tjera të infrastruktures komunale.

Këto vërejtje, sygjerime dhe propozime janë analizuar nga hartuesi i këtij plani në bashkpunim me Dejtorinë e Urbanizmit dhe disa nga to janë inkorporuar deri në masën dhe kufirin që lejojnë standardet urbano-arkitektonike, duke mundësuar e realizimit të këtij Plani.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e komunës së Gjilanit

Gjilan, Mars / 2013.